

**Komisioni për mbajtjen e dëgjimeve publike për kornizën afatmesme buxhetore dhe qarkoren buxhetore të komunës së Suharekës për vitin 2027-2029**

## **PROCESVERBAL**

### **MBI MBAJTJEN E DËGJIMIT PUBLIK ME QYTETARË**

I mbajtur më datë 21/05/2026, në SHFMU “Dëshmorët e Grejkocit” në fshatin Grejkoc, Komuna e Suharekës.

Ora 18:00

#### **1. Baza Ligjore**

**Ky dëgjim publik është mbajtur në bazë të:**

- Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 124, që garanton pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrjen lokale;
- Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Statutit të Komunës së Suharekës;
- Dispozitave tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë organizimin e dëgjimeve publike.

#### **2. Të Pranishmit**

Në këtë dëgjim publik morën pjesë përfaqësues të komunës, përfaqësues të fshatit dhe qytetarë të interesuar.

- Përfaqësuesi i Komunës: Anëtarët e Komisionit – Armend Krasniqi, Mensur Selimaj dhe Shqipron Bytyçi (Procesmbajtës)
- Banorë të fshatit Grejkoc, gjithsej pjesmarrës **10 qytetarë**  
Meshkuj **10**  
Femra **0**

#### **3. Rend Dite**

1. Hapja e takimit dhe prezantimi i pjesëmarrësve;

2. Prezantimi i projekteve dhe planifikimeve komunale;
3. Diskutimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve;
4. Pyetje, komente dhe rekomandime nga qytetarët;
5. Përmbyllja e takimit.

#### 4. Përmbledhje e Diskutimeve

Gjatë dëgjimit publik, qytetarët paraqitën kërkesat, shqetësimet dhe propozimet e tyre lidhur me infrastrukturën lokale, rrugët, ndriçimin publik, furnizimin me ujë, kanalizimin, shërbimet komunale, arsimin dhe çështje tjera me interes publik.

Përfaqësuesit e komunës dhanë sqarime lidhur me projektet aktuale dhe planifikimet për periudhën e ardhshme, duke u zotuar që kërkesat e qytetarëve do të shqyrtohen në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të komunës.

Kërkesat e qytetarëve prezent në këtë Dëgjim Publik:

1. **Bajram Lushaj – qytetar i fshatit Grejkoc**, kërkon ndërhyrjen në shkollë, rregullimin e disa aspekteve teknike në të.
2. **Fazli Tafaj – qytetar i fshatit Grejkoc**, kërkon rregullimin e rrugës segment i rrugës “Shtegu i Lirisë”
3. **Ramadan Canaj – qytetar i fshatit Grejkoc**, kërkon rregullimin e urave në fshat, tæk lagja “Beqiraj” dhe tek rruga kryesore që lidh fshatin me rrugën magjistrale Suharekë Prizren. Po ashtu kërkon rregullimin e rrugëve fushore.
4. **Hasan Kurtishaj – qytetar i fshatit Grejkoc**, kërkon rregullimin e rrugës “Jakup Kurtishaj”
5. **Elmi Kicaj – qytetar i fshatit Grejkoc**, kërkon rregullimin e kanalizimit dhe rrugës në lagjen “Kicaj” – Plishi, rregullimin e parkingjeve tek varrezat e fshatit.


#### 5. Konkluzionet dhe Rekomandimet

- Të evidentohen kërkesat prioritare të qytetarëve;
- Të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së projekteve në planifikimin buxhetor komunal;
- Të vazhdohet organizimi i dëgjimeve publike në të gjitha fshatrat dhe lagjet e komunës;
- Të njoftohen qytetarët për realizimin e rekomandimeve dhe projekteve të planifikuara.

## 6. Përmbyllja

Takimi përfundoi në ora 18:40. Ky procesverbal u hartua për nevoja administrative dhe evidencë zyrtare të komunës.

*Pjesë integrale e këtij procesverballi është po ashtu dhe Lista e Pjesmarrjes, me evidencën e pjesmarrësve.*

Hartuesi i Procesverballit


GREJKOC - 2/105/2026

EMRI	MBIEMRI	FSHATI	NENSHKRIMI
1	HASAN Haxhoj	GREJKOC	Haxhoj
2	RESHAT BEGIMAJ	GREJKOC	BEGIMAJ
3	FABLI TAFAT	GREJKOC	TAFAT
4	HAXHI - ZERELAJ	GREJKOC	ZERELAJ
5	RESHAT CANAJ	GREJKOC	CANAJ
6	KAMURAN CAVAJ	GREJKOC	CAVAJ
7	BOJROM LUSHOJ	GREJKOC	LUSHOJ
8	SMER SELIMAJ	GREJKOC	SELIMAJ
9	ELMI NICALI	GREJKOC	NICALI
10	HASAN HAXHOJ	GREJKOC	Haxhoj
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			